Rregullorja e Unionit të nxënësve të gjimnazit "Kiril Pejçinoviq" - Tetovë

Unioni i nxënësve të gjimnazit "Kiril Pejçinoviq" – Tetovë është strukturë demokratike e themeluar për të përfaqësuar interesat, qëndrimet dhe zërin e të gjithë nxënësve të shkollës. Ai funksionon në përputhje me Ligjin për Arsimin e Mesëm dhe Statutin e shkollës dhe synon të rrisë përfshirjen aktive të nxënësve në jetën institucionale, duke garantuar respektimin e të drejtave të tyre, përfshirjen në vendimmarrje dhe zhvillimin e një kulture të përgjegjësisë kolektive.

Kjo rregullore është dokumenti themelor që përcakton strukturën, funksionet, kompetencat, procedurat e zgjedhjeve, mënyrat e përfaqësimit dhe normat e punës së Unionit të Nxënësve, në mënyrë që veprimtaria e tij të jetë e qartë, transparente dhe në përputhje me vlerat demokratike dhe multietnike të shkollës.

Neni 1- Struktura organizative e Unionit

Unioni i Nxënësve përbëhet nga këto organe:

1. Asambleja e Unionit (organ vendimmarrës)
2. Këshilli Ekzekutiv (organ drejtues dhe zbatues)
3. Komisionet Tematike (trupa funksionale të specializuara)

1. Asambleja e Unionit:

- Përbëhet nga 36 anëtarë, nga të cilët:
- 12 përfaqësues nga vitet e para
- 12 përfaqësues nga vitet e dyta
- 12 përfaqësues nga vitet e treta
- Paralelet në gjuhën maqedonase kanë të garantuar përfaqësim si nxënës në numër minoritar. Numri i vendeve përcaktohet proporcionalisht.
- Çdo klasë ka të drejtë të zgjedhë përfaqësuesin e saj për në Asamble në fillim të vitit shkollor. - Në rast të mungesës ose dorëheqjes së përfaqësuesit të zgjedhur nga një klasë, klasa përkatëse zgjedh një përfaqësues të ri brenda një afati prej 10 ditësh nga momenti i njohjes së mungesës. Në rast të moszgjedhjes, klasa humbet të drejtën e përfaqësimit deri në zgjedhjet e ardhshme.

2. Këshilli Ekzekutiv:

- Është trupi drejtues që zbaton vendimet e Asamblesë dhe merret me administrimin e përditshëm.
- **Përbëhet nga:**
- Kryetari i Unionit
- Zëvendës Kryetari (në çift me Kryetarin)
- Dy Nënkryetarë (një nga nxënësit shqiptarë, një nga nxënësit maqedonas)
- Sekretari

- Përfaqësuesit e katër gjeneratave (I, II, III dhe IV)
- Shefi i PR-it (pa të drejtë vote)

3. Komisionet Tematike:
- Çdo anëtar i Asamblesë është pjesë e detyrueshme e të paktën një komision. - Komisionet janë:
1. Komisioni për Arsim dhe Cilësi Mësimore
2. Komisioni për Kulturë, Art dhe Aktivitete Ekstrakurrikulare
3. Komisioni për Marrëdhënie me Publikun dhe Mediat
4. Komisioni për Sport, Ekologji dhe Shëndet Mendor
5. Komisioni për të Drejtat e Nxënësve dhe Etikën e Jetës Shkollore
6. Komisioni për Projektet, Donacionet dhe Partneritetet
7. Komisioni i Maturës Shtetërore (me 6 anëtarë të vitit të katërt, përfaqësuesi i gjeneratës IV nuk është automatikisht kryetar)
- Kryetarët e komisioneve emërohen nga Këshilli Ekzekutiv.

Neni 2- Funksionet dhe kompetencat e posteve

Kryetari i Unionit:
- Përfaqëson zyrtarisht Unionin në raport me institucionet e shkollës dhe jashtë saj
- Thërret dhe drejton mbledhjet e Këshillit Ekzekutiv dhe Asamblesë
- Propozon rendin e ditës dhe mbikëqyr zbatimin e vendimeve
- Ka të drejtën të refuzojë postime publike ose nisma nëse bien ndesh me qëllimin e Unionit

Zëvendës Kryetari:
- Zgjidhet në të njëjtën fletë votimi me Kryetarin
- Zëvendëson Kryetarin në mungesë ose me autorizim të tij
- Ka kompetenca të plota për veprim në mungesë të Kryetarit

Nënkryetarët:
- Kujdesen për ruajtjen e barazisë ndëretnike dhe ndërgjuhësore
- Njëri nga komuniteti shqiptar dhe tjetri nga ai maqedonas
- Mbikëqyrin komisionet dhe projektet përkatëse

Sekretari:
- Mban procesverbalet dhe dokumentacionin e të gjitha mbledhjeve
- Shpërndan zyrtarisht vendimet
- Administron arkivin digjital të Unionit
- Ndihmon në përpilimin e raportimeve zyrtare

Përfaqësuesit e Gjeneratave:
- Zgjidhen veçmas për secilin vit shkollor pas votimit për Kryetar
- Përfaqësojnë drejtpërdrejt gjeneratën e tyre në Këshillin Ekzekutiv

Shefi i PR-it:
- Emërohet nga ana e kryetarit
- Koordinon komunikimin në rrjetet sociale dhe publikimet
- Menaxhon Komisionin për Marrëdhënie me Publikun
- Pa të drejtë vote, por merr pjesë në mbledhje me rol këshillues

Neni 3- Procedura e zgjedhjeve

Zgjedhjet e rregullta:
- Shpallen nga Drejtoria ose Kryesia e Unionit
- 4 ditë para ditës së votimit
- Kandidaturat paraqiten 1 ditë pas shpalljes
- Fushata zgjat 2 ditë
- Votimi realizohet me fletë votimi në kuti të mbyllura, me proces të fshehtë
- Votimi zhvillohet në prani të Komisionit Zgjedhor të përbërë nga nxënës dhe drejtues
- Rezultatet shpallen publikisht brenda disa çasteve nga numërimi
- Pas kësaj, Asambleja e re zgjedh me votim të hapur:
- Sekretarin
- Dy Nënkryetarët

Zgjedhjet e jashtëzakonshme:
- Bëhen në rast të dorëheqjes së Kryetarit ose shpërbërjes së Unionit
- Klasifikohen sipas datës:
- Para 15 marsit: votim nga vitet I, II dhe III, mandati i të zgjedhurit/ës zgjat deri në qershor të atij viti shkollor dhe si rrjedhojë quhet kryesi e përkohshme
- Pas 15 marsit: votim vetëm nga vitet I dhe II, pasi mandati përfshin vitin e ardhshëm

Zgjedhjet pas miratimit të rregullores ose pas ndonjë ndryshimi eventual që faktorizon ndryshime të mëdha në rregullore:
- Konsiderohen zgjedhje të jashtëzakonshme
- Shpallen brenda 5 ditëve nga miratimi i rregullores
- Mbikëqyren plotësisht nga Drejtoria e shkollës
- Çdo kandidat për postin e Kryetarit të Unionit, për t'u regjistruar zyrtarisht në garë, është i detyruar të dorëzojë një platformë të shkruar që përmban programin dhe objektivat për mandatin. Platforma duhet të dorëzohet së bashku me kandidaturën dhe verifikohet nga Komisioni i Autorizuar i Stafit të Shkollës, i cili konstaton nëse përmbajtja është në

përputhje me vlerat e shkollës, rregulloren e Unionit dhe standardet arsimore. Vetëm kandidatët me platformë të verifikuar dhe të aprovuar fitojnë të drejtën për të marrë pjesë në fushatë dhe votim.

Neni 4- Mandati dhe dorëzimi

- Mandati i Kryetarit dhe Zëvendësit zgjat një vit
- Mandati fillon pas shpalljes së rezultatit zyrtar
- Drejtori i shkollës dorëzon mandatin me shkrim dhe dokumentacion të nënshkruar kryetarit të sapozgjedhur në afat prej 3 ditëve

-Thirrja e Mbledhjes për Miratimin e Platformës

Kryetari i sapozgjedhur, brenda një afati prej 5 ditësh kalendarike nga marrja e mandatit, është i detyruar të thërrasë një mbledhje të jashtëzakonshme të Asamblesë, në të cilën prezanton dhe kërkon miratimin formal të platformës së tij/saj të kandidimit.

Platforma e miratuar do të jetë baza e raportimit të punës së Unionit gjatë mandatit njëvjeçar.

Neni 5- Mbledhjet dhe veprimtaria

- Asambleja mblidhet një herë në muaj, sipas rendit të ditës të shpallur 2 ditë përpara
- Mbledhjet janë të hapura për vëzhguesit nga radhët e nxënësve
- Procesverbalet ruhen në arkivën zyrtare digjitale

Neni 6- Dita e hapur e Unionit

- Zhvillohet në javën e parë ose të dytë të tetorit
- Ka për qëllim prezantimin e strukturës së Unionit, raportimin e planit vjetor dhe hapjen ndaj pjesëmarrjes
- Përfshin diskutime të hapura, forume interaktive dhe regjistrim në komisione

Neni 7- Përfaqësimi në Këshillin e Shkollës

- Unioni i Nxënësve zgjedh një përfaqësues të nxënësve në Këshillin e Shkollës me votim tëhapur nga Asambleja.
- Përfaqësuesi i zgjedhur ka të drejtë të marrë pjesë në të gjitha mbledhjet e Këshillit të Shkollës ku shqyrtohen çështje që lidhen me të drejtat, interesat dhe jetën e nxënësve.
- Përfaqësuesi ka të drejtë të paraqesë mendime, propozime dhe rekomandime në emër të Unionit të Nxënësve.
- Mandati i përfaqësuesit është një vit, me mundësi rizgjedhjeje sipas nevojës dhe vlerësimit të Asamblesë.

Neni 8- Organizimi i aktiviteteve dhe pjesëmarrja në evente jashtëshkollore

- Unioni i Nxënësve ka të drejtë të organizojë aktivitete kulturore, sportive, edukative, sociale dhe humanitare në bashkëpunim me Drejtorinë e shkollës.
- Për aktivitete madhore që përfshijnë pjesëmarrje të gjerë ose ndikim në programin mësimor, kërkohet miratim paraprak nga Drejtoria.
- Unioni ka të drejtë të përfaqësojë shkollën në aktivitete lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare, në bazë të ftesave dhe marrëveshjeve të miratuara nga Drejtoria.
- Përfaqësuesit për evente jashtëshkollore zgjidhen nga Këshilli Ekzekutiv ose përmes vendimit të Asamblesë.

Neni 9- Bashkëpunimi me organet drejtuese të shkollës

- Unioni i nxënësve bashkëpunon me Drejtorinë e shkollës, Këshillin e Arsimtarëve dhe Këshillin e Shkollës për të mbrojtur interesat e nxënësve dhe për të kontribuar në zhvillimin e jetës shkollore.
- Drejtoria është e detyruar, në përputhje me këtë Rregullore, të konsultojë Unionin për çdo çështje që prek drejtpërdrejt të drejtat, obligimet dhe pjesëmarrjen institucionale të nxënësve.
- Unioni ka të drejtë të paraqesë propozime me shkrim, mendime ose ankesa në organetpërkatëse, të cilat duhet të shqyrtohen brenda një afati të arsyeshëm kohor.
- Bashkëpunimi bazohet në parimet e respektit reciprok, transparencës dhe bashkëpunimit konstruktiv.

Neni 10- Arkivimi dhe marrëdhëniet me publikun

- Të gjitha dokumentet e Unionit ruhen në arkiv digjital me akses të kontrolluar
- Komunikimet zyrtare dhe rrjetet sociale menaxhohen nga Komisioni për Marrëdhënie me Publikun
- Çdo publikim duhet të miratohet nga Kryetari
- Aksesin në arkivën digjitale të Unionit e kanë ekskluzivisht Kryetari dhe Sekretari i Unionit. Çdo ndryshim ose qasje tjetër duhet të autorizohet me vendim të posaçëm të Këshillit Ekzekutiv.

Neni 10/a – Kodi i Sjelljes për Komunikimet Publike dhe Mediat Sociale

1. Të gjitha postimet, komentet dhe publikimet e Unionit në rrjetet sociale duhet të respektojnë vlerat e tolerancës, respektit dhe profesionalizmit.
2. Është rreptësisht e ndaluar publikimi i përmbajtjeve që përmbajnë:

   - Gjuhë fyese ose diskriminuese
   - Informacione të pasakta, lajme të rreme ose dezinformuese
   - Komente politike, fetare apo partiake që nuk përfaqësojnë interesin kolektiv të nxënësve

3. Çdo postim zyrtar duhet të miratohet paraprakisht nga Kryetari ose Shefi i PR-it dhe të dokumentohet në arkivën digjitale.
4. Në rast shkeljesh të kodit, Këshilli Ekzekutiv ka të drejtë të shqyrtojë rastin dhe të ndërmarrë masa disiplinore, përfshirë heqjen e të drejtës së publikimit ose përjashtim të përkohshëm nga pozita përkatëse.

Neni 11- Iniciativat e nxënësve

- Çdo nismë që mbledh të paktën 50 nënshkrime të nxënësve të shkollës duhet të futet në rendin e ditës së Asamblesë
- Kryetari është i detyruar ta procedojë brenda 10 ditëve
- Iniciativa shqyrtohet dhe votohet në mbledhje zyrtare
-Pas futjes së nismës në rendin e ditës, Asambleja është e detyruar ta shqyrtojë dhe të marrë vendim përfundimtar brenda 30 ditëve kalendarike.

Neni 12- Komisioni i maturës shtetërore

- Përbëhet nga 6 anëtarë të viteve të katërta
- Anëtarët zgjidhen nga kryetarët e klasave përkatëse
- Kryetari i këtij komisioni zgjidhet veçmas, nuk është automatikisht përfaqësuesi i gjeneratës - Ka mandat njëvjeçar dhe funksion këshillues
- Roli i tij është të ndërmjetësojë midis maturantëve, Unionit dhe Drejtorisë për çdo çështje që lidhet me maturën

Neni 13- Këshilli për kontroll të brendshëm

Këshilli për kontroll të brendshëm është organ për kontroll i përbërë nga 5 anëtarë nga të cilët 4 janë përfaqësues të secilës gjeneratë ndërsa njëri Kryetar i këshillit për kontroll të brendshëm. Kryetari i Unionit të nxënësve merr pjesë në mbledhjet e punës së Këshillit për kontroll të brendshëm.
Kryetarin e Këshillit për kontroll të brendshëm e zgjedhin anëtarët e Këshillit për kontroll të brendshëm. Mandati i anëtarëve të Këshillit për kontroll të brendshëm zgjat 1 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje dy vjet me rradhë.

Neni 14- Mjetet materiale të Unionit të nxënësve, sigurimi dhe shpenzimi i tyre

Për realizimin e qëllimeve dhe detyrave të parashtruara, Unioni i nxënësve mjetet materiale, gjegjësisht të drejtat e caktuara për mjetet materiale i disponon në pajtueshmëri me këtë Rregullore dhe Ligjet adekuate.
Unioni i nxënësve të gjimnazit, mjetet materiale dhe materialet tjera i siguron nëpërmjet:
- Donatorëve
- Sponzorëve
- Aktiviteteve vetanake

Shfrytëzimi i mjeteve bëhet në mënyrë ligjore. Me mjetet udhëheq Sekretari – procesverbalist. Mjetet mund të shfrytëzohen vetëm për qëllime të sjellura nga Këshilli i Unionit të nxënësve në bazë të dokumentit përkatës financiar.

Neni 15 – Kuorumi i Mbledhjeve dhe Vendimmarrjes

1. Mbledhjet e Asamblesë janë të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë të paktën 50% +1 e anëtarëve me të drejtë vote.
2. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë votash, përveç rasteve kur kërkohet shumicë e cilësuar sipas kësaj Rregulloreje.
3. Në rast të mungesës së kuorumit, mbledhja shtyhet për 48 orë dhe njoftimi publikohet menjëherë.
4. Në çdo proces votimi për zgjedhje, përfshirë rastet kur ka më shumë se një kandidat ose vetëm një, çdo kandidat për pozitat drejtuese si Kryetar, Zëvendëskryetar, Sekretar, Nënkryetar është i detyruar të marrë mbështetjen e të paktën 50% +1 të të gjithë anëtarëve të Asamblesë me të drejtë vote) për t'u konsideruar i/e zgjedhur.

Neni 16 – Sanksione për Pasivitet dhe Mungesë të Pajustifikuar

1. Çdo anëtar i Asamblesë ose Këshillit Ekzekutiv që mungon në tre (3) mbledhje radhazi pa arsye, të paraqitura me shkrim, konsiderohet i shkarkuar automatikisht.
2. Shkarkimi verifikohet nga Sekretari dhe formalizohet me vendim të Këshillit Ekzekutiv.
3. Kryetari i Unionit nuk ka të drejtë të shkarkojë asnjë anëtar të Këshillit Ekzekutiv në mënyrë të njëanshme. Një anëtar mund të shkarkohet vetëm nëse propozimi i shkarkimit mbështetet nga shumica e thjeshtë (50% +1) e anëtarëve të Këshillit Ekzekutiv në mbledhje të rregullt, pas verifikimit të arsyeve për shkarkim.

Neni 17 – Zgjidhje për Mungesën e Kandidaturave

1. Nëse nuk ka kandidatura të vlefshme për Kryetar, procesi shtyhet për 5 ditë dhe rishpallet me thirrje publike.
2. Në rast mungese të vazhdueshme, Drejtoria emëron një trupë të përkohshme administruese deri në përmbushjen e kushteve për zgjedhje.

Neni 18– Emërimi në Rastin e Mungesës së Kandidaturave për poste të tjera drejtuese përveç Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit

1. Nëse për poste drejtues në Këshillin Ekzekutiv (si Nënkryetar, Sekretar, Përfaqësues i gjeneratave) nuk paraqitet asnjë kandidaturë brenda afatit zyrtar, Kryetari i Unionit ka të drejtë të propozojë një kandidat.
2. Kandidatura e propozuar duhet të miratohet me votim të hapur nga Asambleja dhe të marrë shumicën e thjeshtë të votave për të hyrë në fuqi.
3. Nëse propozimi refuzohet dy herë radhazi, hapet një thirrje e re për kandidatura brenda 5 ditëve.
4. Kjo dispozitë nuk zbatohet për postin e Zëvendëskryetarit, i cili zgjidhet ekskluzivisht me fletë votimi si çift me Kryetarin.

Neni 19 – Mosmiratimi i Platformës së Kryetarit

1. Nëse Asambleja nuk miraton platformën e Kryetarit të sapozgjedhur, ai/ajo duhet të paraqesë një version të rishikuar brenda 5 ditëve.
2. Nëse refuzohet edhe versioni i dytë, organizohen zgjedhje të jashtëzakonshme brenda 7 ditëve.

Neni 20 – Transparencë Financiare dhe Raportim Publik

1. Unioni përgatit një raport financiar dhe një raport vjetor të punës deri më 30 qershor të çdo viti.
2. Raporti publikohet në formë të hapur për gjithë nxënësit dhe dorëzohet te Drejtoria për arkivim zyrtar.
3. Raporti përfshin të ardhurat, shpenzimet, aktivitetet e zhvilluara dhe vlerësimin e rezultateve.

Neni 21 – Kufizimi dhe Transparenca e Ndërhyrjeve të Drejtorisë

1. Drejtoria mbikëqyr legjitimitetin procedural të Unionit, por nuk ndërhyn në përmbajtjen politike të vendimmarrjes së nxënësve.
2. Çdo refuzim apo ndërhyrje duhet të jepet me shkrim dhe të nënshkruhet nga drejtori i shkollës.
3. Unioni ka të drejtë të kërkojë rishikim të vendimit brenda 5 ditëve përmes ankesës zyrtare.

Neni 22 – Funksionimi dhe Raportimi i Komisioneve

1. Çdo komision ka detyrim të hartojë një plan pune tremujor dhe ta dorëzojë për miratim në Këshillin Ekzekutiv.
2. Kryetarët e komisioneve janë të detyruar të raportojnë në Asamble në fund të çdo tremujori për progresin dhe sfidat.
3. Në mungesë aktiviteti për më shumë se 50 ditë, Këshilli Ekzekutiv ka të drejtë të kërkojë riorganizim ose riformatim të komisionit.

Neni 23 – Barazi Ndëretnike dhe Gjinore

1. Në përputhje me karakterin multietnik të shkollës dhe të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Unioni garanton përfaqësim të drejtë ndëretnik dhe gjinor në të gjitha strukturat.
2. Në rast kandidaturash të barabarta, përparësi i jepet atyre që përfaqësojnë gjininë apo komunitetin më pak të përfaqësuar në atë trupë.

Neni 24 – Përbërja e Këshillit Ekzekutiv

1. Këshilli Ekzekutiv përbëhet nga: Kryetari, Zëvendëskryetari, dy Nënkryetarë (një shqiptar, një maqedonas), Sekretari, përfaqësuesit e gjeneratave dhe koordinatori i sekretariatit nëse ekziston.
2. Anëtarë me rol këshillues (pa të drejtë vote) mund të ftohen sipas nevojës, si kryetarët e komisioneve dhe përfaqësuesi për Marrëdhënie me Publikun.

Neni 25 – Vlerësimi i Performancës dhe Llogaridhënia

1. Në fund të vitit shkollor, realizohet një vlerësim i performancës së Unionit përmes një pyetësori gjithëpërfshirës për nxënësit.
2. Vlerësimi publikohet dhe shërben si bazë për planifikim të ardhshëm dhe për rritjen e cilësisë së punës institucionale.
3. Pyetësori hartohet nga një grup i përbashkët i Këshillit Ekzekutiv dhe një përfaqësues i Drejtorisë.

Neni 26 – Mbledhjet e Rregullta të Asamblesë

1. Asambleja është e detyruar të zhvillojë katër (4) mbledhje të rregullta gjatë vitit shkollor në këto periudha:
    - Në fillim të tetorit
    - Në fund të dhjetorit
    - Në fund të muajit shkurt
    - Në fillim të muajit qershor
2. Përveç këtyre, mbledhje të jashtëzakonshme mund të thirren sipas nevojës nga Kryetari, Këshilli Ekzekutiv ose me kërkesë të një të tretës së anëtarëve të Asamblesë.
3. Njoftimi për mbledhjet e rregullta dhe të jashtëzakonshme duhet të shpallet të paktën 2 ditë përpara datës së zhvillimit.

Neni 27 – Seanca Zgjedhore e Viteve të Katërta

1. Pas përfundimit të seancës zgjedhore të përgjithshme për Kryetarin dhe Zëvendëskryetarin e Unionit, mbahet një seancë e veçantë zgjedhore vetëm me përfaqësuesit e viteve të katërta.
2. Në këtë seancë, nxënësit e vitit të katërt zgjedhin përfaqësuesin e gjeneratës së tyre për Këshillin Ekzekutiv.
3. Po ashtu, gjatë kësaj seance zgjidhen edhe anëtarët e Komisionit të Maturës Shtetërore, në përputhje me dispozitat përkatëse të kësaj Rregulloreje.
4. Mbledhja duhet të zhvillohet brenda 48 orëve nga përfundimi i procesit të votimit të përgjithshëm.
5. Nxënësit e vitit të katërt mund të kandidojnë për postin e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit të Unionit vetëm nëse gjatë vitit të tretë kanë ushtruar funksione të rregullta në Këshillin Ekzekutiv dhe ky angazhim është i verifikuar me dokumentacion zyrtar nga Sekretari.
6. Për pozita të tjera në Këshillin Ekzekutiv, si Nënkryetar apo Sekretar, përvoja e mëparshme në strukturat e Unionit është e preferueshme, por jo kusht i domosdoshëm.
7. Për përfaqësuesit e gjeneratave dhe anëtarët e komisioneve, përvoja e mëparshme është e mirëpritur, por jo e detyrueshme.

Neni 28 – Zgjedhja e Përfaqësuesve të Gjeneratave

1. Çdo gjeneratë (viti i parë, i dytë, i tretë dhe i katërt) përfaqësohet në Këshillin Ekzekutiv nga një përfaqësues i zgjedhur me votim të hapur nga përfaqësuesit e klasave të asaj gjenerate.

2. Votimi organizohet nga Sekretariati Organizativ i Unionit brenda 10 ditëve nga konstituimi i Asamblesë.
3. Nëse ndonjë gjeneratë nuk arrin të përzgjedhë përfaqësuesin brenda afatit të përcaktuar, Këshilli Ekzekutiv shpall thirrje të re dhe cakton një datë të re zgjedhjeje.
4. Mandati i përfaqësuesit të gjeneratës është një vit shkollor, me mundësi rizgjedhjeje.

Neni 29 – Dokumentimi dhe Ruajtja e Vendimeve

1. Çdo mbledhje e Asamblesë dhe Këshillit Ekzekutiv duhet të dokumentohet me procesverbal të nënshkruar nga Sekretari dhe miratuar nga Kryetari.
2. Procesverbalet ruhen në arkivën digjitale të Unionit dhe janë të qasshme me kërkesë zyrtare nga anëtarët.
3. Vendimet kryesore si zgjedhjet, ndryshimet strukturore dhe buxhetore duhet të shoqërohen me një dokument zyrtar të veçantë, me referencë të mbledhjes përkatëse.
4. Të paktën një herë në vit, përmbledhja e vendimeve dhe aktivitetit institucional publikohet për informimin e të gjithë nxënësve.

Neni 30 – Emërimi i Kryetarëve të Komisioneve

1. Kryetarët e komisioneve emërohen nga Këshilli Ekzekutiv në mbledhjen e parë pas konstituimit të tij.
2. Propozimet për kryetarë mund të paraqiten nga çdo anëtar i Këshillit Ekzekutiv, përfshirë Kryetarin.
3. Për të siguruar përfaqësim të drejtë dhe kompetencë funksionale, emërimi duhet të bazohet në angazhimin paraprak dhe interesin konkret të anëtarit në fushën e komisionit.
4. Emërimi formalizohet me shumicë të thjeshtë votash nga Këshilli Ekzekutiv dhe publikohet menjëherë pas vendimit.
5. Nëse një kryetar komisioni rezulton pasiv ose nuk kryen detyrat në përputhje me planin e miratuar, Këshilli Ekzekutiv ka të drejtë të kërkojë rishikimin e mandatit të tij dhe të votojë për zëvendësimin me shumicë të thjeshtë votash.
6. Shefi i Marrëdhënieve me Publikun (PR) emërohet drejtpërdrejt nga Kryetari i Unionit, në bazë të besimit, përvojës dhe gatishmërisë për të përfaqësuar publikisht qëndrimet dhe veprimtarinë e Unionit. Ai/ajo ka rol këshillues në Këshillin Ekzekutiv dhe nuk gëzon të drejtë vote.

Neni 31 – Përbërja e Këshillit Ekzekutiv

1. Këshilli Ekzekutiv përbëhet nga:
    - Kryetari i Unionit
    - Zëvendëskryetari i Unionit
    - Dy Nënkryetarë (njëri nga komuniteti shqiptar dhe tjetri nga komuniteti maqedonas)
    - Sekretari
    - Katër përfaqësues të gjeneratave (nga vitet I, II, III dhe IV)
2. Anëtarë me rol këshillues, pa të drejtë vote, janë:
    - Shefi i Marrëdhënieve me Publikun
    - Kryetarët e Komisioneve Tematike

Neni 32 – Kufizimi i Mandateve në Këshillin Ekzekutiv

1. Çdo anëtar i Këshillit Ekzekutiv, pavarësisht pozitës që ka mbajtur (Kryetar, Zëvendëskryetar, Sekretar, Nënkryetar), mund të ushtrojë funksione në këtë trup për një maksimum prej dy viteve shkollore gjithsej.
2. Këto dy vite mund të jenë të njëpasnjëshme ose të ndara, por pas përmbushjes së këtij afati, anëtari nuk mund të rikandidojë apo të emërohet në asnjë funksion tjetër brenda Këshillit Ekzekutiv.

Neni 33

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij.
2. Këshilli Ekzekutiv, me miratim nga Asambleja, mund të propozojë ndryshime ose përmirësime të kësaj rregulloreje.
3. Në raste të tilla, thirret mbledhje zyrtare me Drejtorinë dhe Këshillin e Shkollës për shqyrtim dhe miratim formal të versionit të ri të përditësuar.

Neni 34- Dispozita kalimtare

- Me miratimin e kësaj rregulloreje nga Këshilli i Shkollës, strukturat ekzistuese të Unionit konsiderohen të shkarkuara
- Brenda 5 ditëve shpallen zgjedhjet e reja të jashtëzakonshme
- Këto zgjedhje klasifikohen si të parakohshme pas datës 15 mars dhe mandati i Kryetarit të ri vlen për një vit të plotë

Neni 35- Dispozita përfundimtare

Të drejtë interpretimi të kësaj Rregullore kanë Këshilli i Unionit të nxënësve, Këshilli për kontroll
të brendshëm dhe Kryetari i Unionit të nxënësve.